



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga "Abdi Toptani" ish- hotel "Drini", Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 1536/7 Prot.

Tiranë, më 31.08.2017

V E N D I M

Nr. 186, datë 31.08.2017

*"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit, të filluar me urdhrin nr. 1536/1 prot., datë 27.7.2017, të Komisionerit "Për verifikimin e informacionit që përmban shkresa me nr. 1536 prot., dt. 27.7.2017, mbi mënyrën e realizimit të procedurës gjatë zhvillimit të ecuresë disiplinore", për punonjës in *****.*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenet 14 e 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procedurës së verifikimit,

VËREJ SE :

Nëpërmjet informacionit të dërguar nga punonjësi ***** , me detyrën "Specialist", në Sektorin e Administrimit të Tokës, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave dhe Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, protokolluar me shkresën nr. 1536 prot., datë 27.7.2017, ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, se me vendimin nr. 27, datë 25.7.2017, të Komisionit disiplinor, është vendosur largimi i tij nga shërbimi civil", duke pretenduar se gjatë procedimit disiplinor, janë shkelura rregullat e administrimit të shërbimit civil.

Në këto rrethana, me urdhrin nr. 1536/1 prot., dt. 27.7.2017, Komisioneri, ka filluar hetimin administrativ për verifikimin e mënyrës se si janë respektuar rregullat procedurale gjatë ecuresë disiplinore të zhvilluar për nëpunësin ***** , duke përfshirë edhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimarrjen e komisionit disiplinor në këtë rast, si dhe të gjithë aktorëve të tjerë të përfshirë në këtë proces.

Procesi i hetimit ka vijuar me dërgimin e shkresave nr. 1536/3 dhe 1536/4, datë 27.7.2017, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe

Administrimit të Ujërave dhe Departamentit të Administratës Publike, nëpërmjet të cilave është njoftuar institucioni për fillimin e verifikimit të informacionit, e po kështu janë kërkuar nga këto institucione, provat që kanë shërbyer si bazë për fillimin e ecurisë disiplinore, si dhe të gjitha aktet shkresore që materializojnë procedurat e realizuara gjatë marrjes së masës disiplinore ndaj punonjësit në fjalë.

Në përgjigje të këtij njoftimi, nga ana e ministrisë, me shkresën nr. 5801/1 prot., datë 2.8.2017, "*Kthim përgjigje*", është dërguar dokumentacioni, ku pasqyrohen veprimet e kryera në këtë rast, duke filluar nga njoftimi për fillimin e ecurisë disiplinore, akti i krijimit të komisionit disiplinor, procesverbali i shqyrtimit të ecurisë disiplinore, si dhe vendimi përfundimtar për marrjen e masës disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*".

Ndërkohë, edhe nga ana e Departamentit të Administratës Publike, me shkresën nr. 4931/1 prot., datë 31.7.2017 "*Kthim përgjigje*", janë dërguar materialet shkresore që disponon në lidhje me këtë rast.

Nga analiza e akteve të dërguara prej institucioneve si dhe nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultoi se,

Punonjësi ******, me aktin nr. 1609/63, datë 13.11.2013 të Departamentit të Administratës Publike "*Sistemim pas ristrukturimit të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave*", është sistemuar në pozicionin "*Specialist në Sektorin e Administrimit të Tokës*", në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave dhe Tokës, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave. (*Ka punuar në këtë institucion pa ndërprerje nga viti 2002 e në vazhdim, emëruar me aktin nr. 2788/1, datë 13.8.2002*). Pra, pozicioni i punës është pjesë e aparatit të një ministrie e për rrjedhojë, është pjesë e shërbimit civil. Bazuar në përcaktimet e pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, punonjësi në fjalë është nëpunës civil, për pasojë, ai gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton ky ligj.

Nga analiza e përmbajtjes së aktit administrativ objekt shqyrtimi, që në këtë rast është vendimi nr. 27, datë 25.7.2017, i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, rezulton se ndodhemi në kushte e zhvillimit të një ecurie disiplinore ndaj një nëpunësi civil.

Në këtë rast, ligji për nëpunësin civil, ka parashikuar si detyrim, zhvillimin e një tërësie veprimesh procedurale, të cilat duhet të zbatohen sipas rendit të përcaktuar në kreun X, titulluar "*Disiplina në shërbimin civil*", të ligjit në fjalë. Po kështu, këto detyrime ligjore, janë specifikuar edhe në vendimin nr. 115, datë 5.3.2015 të Këshillit të Ministrave, "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*", nga pika 1 deri në 20 të tij, si edhe në udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014 të Departamentit të Administratës Publike "*Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore*".

Duke vlerësuar veprimet administrative që janë kryer gjatë këtij procedimi disiplinor, nga momenti i raportimit të shkeljes disiplinore të pretenduar (*ankesa e paraqitur në datën 13.7.2017 nga Përgjegjësjë e Sektorit të Administrimit të Tokës, që është sektori ku punon ******), e deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor (*vendimi nr.*

27, datë 25.7.2017 i Komisionit Disiplinor, për marrje mase disiplinore “Largim nga shërbimi civil”), rezultoi e provuar si më poshtë:

Shkak për fillimin e kësaj ecurie disiplinore, ka qenë një ankesë (e pa protokolluar), e punonjësës *****, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Tokës, në Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Ujërave dhe Tokës në MBZHRAU, e paraqitur pranë Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, në datën **13.7.2017**, duke pretenduar se, një nga vartësit e saj, e konkretisht punonjësi *****, është sjellë në mënyrë të parregullt me të, duke përdorur një fjalor që nuk përshtatet me etikën dhe rregullat në administratën publike.

Menjëherë pas vënies në dijeni për shkeljen disiplinore të pretenduar, Sekretari i Përgjithshëm i MBZHRAU, me shkresën nr. 5470 prot., datë **14.7.2017**, “Mbi fillimin e procedimit disiplinor”, ka njoftuar nëpunësin ***** për fillimin e ecurisë disiplinore.

Nisur nga përmbajtja e këtij akti, rezulton se motivacioni i fillimit të ecurisë disiplinore është përcaktuar si (citojmë pjesë nga njoftimi) “... sjellje e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun”, e cila klasifikohet nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, si shkelje e rëndë, duke përcaktuar si bazë ligjore nenin 57, pika 3, shkronja “ç”.

Konstatohet se, në të njëjtën ditë me njoftimin e nëpunësit për fillimin e ecurisë disiplinore, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, ka nxjerrë edhe shkresën nr. 5470/1 prot., datë 14.7.2017, “Kërkohet caktimi i përfaqësuesit në Komisionin Disiplinor”, duke i kërkuar njësisë përgjegjëse DAP që të caktojë një përfaqësues të saj si anëtar të Komisionit Disiplinor, për shqyrtimin e shkeljes disiplinore të pretenduar për nëpunësin *****. Në nxjerrjen e kësaj shkrese është përmendur si mbështetje ligjore, e njëjta dispozitë që është përshkruar në aktin e fillimit të ecurisë, konkretisht neni 57, pika 3, shkronja “ç” e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku parashikohet “sjellja e parregullt, në mënyrë të përsëritur, gjatë kohës së punës me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun”, e klasifikuar si shkelje e rëndë në shërbimin civil.

Më tej, rezulton se, me urdhrin nr. 326, datë 19.7.2017 (nr. 5470/2 prot., dt. 19.7.2017), të Sekretarit të Përgjithshëm, është krijuar Komisioni Disiplinor, i cili në datën **25.7.2017**, është mbledhur për shqyrtimin e çështjes në fjalë, sipas rendit të ditës që ka dalë në të njëjtën ditë, pra në datën 25.7.2017, i cili në fakt, rezulton i pa nënshkruar nga kryetari i KD dhe i pa protokolluar sipas kërkesave ligjore.

Në rastin që po trajtojmë, përgjegjësi i sektorit, i cili paraqitet si zyrtar me detyra kontrolli hierarkik, ka pretenduar për shkelje disiplinore të kryer nga një nëpunës në varësi të drejtpërdrejtë të tij, rast ky i parashikuar në pikën 4, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Në kushte të tilla, mund të zbatoheshin rregullat e parashikuara në pikën 11, të kreut II, të VKM nr. 115, datë 5.3.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, ku parashikohet në mënyrë të shprehur se: “Në rast se eprori direkt vihet në dijeni për një shkelje disiplinore nga subjektet e përcaktuara në shkronjën “b”, të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013, eprori direkt fillon menjëherë ecurinë

disiplinore, ose nëse nuk është kompetent për shqyrtimin e saj, ai përcjell informacionin KD". Në zbatim të kësaj dispozite, informacioni për shkeljen disiplinore të pretenduar për punonjësin në fjalë, duhet të mos anashkalonte Drejtorin e Drejtorisë, apo Drejtorin të Përgjithshëm, në cilësinë e eprorit direkt në kuptim të ligjit, për të vlerësuar rëndësinë e shkeljes dhe organin që do të zhvillonte ecurinë disiplinore.

Ndërsa, në rastin konkret, konstatohet se, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit është investuar personalisht për klasifikimin e shkeljes disiplinore, si dhe për fillimin e ecurisë disiplinore, duke marrë në këtë mënyrë atributet e organit disiplinor.

Në pikën 1, të kreut I, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave "*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*", janë përcaktuar organet disiplinore në shërbimin civil, sipas ligjit, në këtë mënyrë:

"Organet disiplinore, sipas ligjit janë Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); komisioni disiplinor (KD), për nëpunësit e tjerë, dhe eprori direkt".

Në rastin në fjalë, rezulton se është kapërcyer eprori direkt si organ disiplinor që bën vlerësimin dhe klasifikimin e shkeljes disiplinore të pretenduar.

Nga ana tjetër, edhe nëse do të vlerësojmë se në këtë rast, organi disiplinor është Komisioni Disiplinor, duke e konsideruar ankesën e përgjegjës të sektorit, të paraqitur nga subjekt me cilësinë e zyrtarit me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin në fjalë, sipas parashikimeve të nenit 59, pika 4/b, ku përcaktohet shprehimisht se: "*Komisioni disiplinor fillon procedimin: a) me kërkesë të eprorit direkt të nëpunësit civil; b) me rekomandim të çdo organi tjetër publik ose njësie me kompetenca kontrolli administrativ, inspektimi financiar apo auditi, ose të çdo zyrtari tjetër me detyra kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil, c) me nismën e çdo anëtari të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore*", përsëri konstatohen shkelje flagrante të procedurave ligjore që sigurojnë respektimin e të drejtave të nëpunësit civil.

Në këtë përfundim arrihet për faktin se, ashtu si është analizuar më sipër, në rastin konkret, njoftimi i nëpunësit që pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore është kryer në datën 14.7.2017, (shkresa nr. 5470 prot., datë 14.7.2017 e Sekretarit të Përgjithshëm të MBZHRAU), ndërkohë që provohet se, Komisioni Disiplinor është ngritur me urdhrin nr. 326, datë 19.7.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe e ka filluar veprimtarinë e tij me mbledhjen e datës 25.7.2017, ku edhe është marrë vendimi nr. 27, datë 25.7.2017 për marrje mase disiplinore "*Largim nga shërbimi civil*", objekt i këtij shqyrtimi.

Ky fakt vërteton se, shkresa nr. 5470 prot., datë 14.7.2017, "*Mbi njoftimin e procedimit disiplinor*", e Sekretarit të Përgjithshëm, ka dalë në shkelje të rregullave të parashikuara në ligj dhe në aktet nënligjore që rregullojnë institutin e disiplinës në shërbimin civil, e konkretisht në pikën 13, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014, ku përcaktohet shprehimisht se: "*Në rastin e marrjes dijeni për një shkelje disiplinore, organi disiplinor fillon ecurinë disiplinore dhe njofton me shkrim nëpunësin përkatës*".

Në këto rrethana, provohet se Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, ka njoftuar nëpunësin ***** për fillimin e ecurisë disiplinore, në një kohë kur ende nuk ishte krijuar organi

disiplinor që duhet të vlerësohet nëse, *a*) duhet të fillonte ose jo ecuria disiplinore, *b*) organin që do ta realizonte këtë ecuri, si dhe *c*) klasifikimin e shkeljes së kryer, duke përvetësuar në këtë mënyrë, atributet e Komisionit Disiplinor, e duke vepruar në kapërcim të kompetencave ligjore të këtij pozicioni, i cili parashikohet nga ligji, gjatë një procedure disiplinore, vetëm si pjesë e Komisionit Disiplinor, i cili mund të marrë vendime si një organ kolegjal.

Për këtë arsye, në kushtet kur, akti i fillimit të ecurisë disiplinore, si një aspekt i domosdoshëm procedural për dhënien e një mase disiplinore, është një akt absolutisht i pavlefshëm, i cili në këtë rast konsiderohet se nuk ekziston, sipas parashikimeve të nenit 110/1, nëntitulli “*Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute*”, të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, ku parashikohet se: “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston*”, atëherë i gjithë veprimi juridik që është kryer në këtë rast nga KD, është absolutisht i pavlefshëm, duke përfshirë edhe aktin e largimit nga shërbimi civil, pasi procedura në këtë rast vlerësohet si e pa realizuar.

Për më tepër, nga analiza e rrethanave të rastit, si dhe e provave të administruara, konstatohen edhe një sërë parregullsish, që kanë të bëjnë me aspektin material të trajtimit të çështjes, të cilat po i parashtrijmë më poshtë.

Së pari: Procedura disiplinore ka filluar me kërkesë të paraqitur nga një nëpunës brenda institucionit, me pretendimin e sjelljes së parregullt në ambientet e institucionit. Në një rast të tillë, pika 2, e kreut II, të vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil*”, parashikon se:

*“Nëpunësit e institucionit, kur kanë dijeni apo dyshojnë për shkelje disiplinore, të kryera nga nëpunës të tjerë të të njëjtës institucion, **duhet t’ia raportojnë atë, me shkrim, eprorit direkt të nëpunësit për të cilin pretendohet se ka kryer shkeljen**”.*

Në rastin në fjalë, punonjësja M. Shahini, më detyrë “*Përgjegjëse e Sektorit të Administrimit të Tokës*”, (përgjegjëseja e sektorit ku punon ankuesi), ankesën e ka paraqitur pranë Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, duke pretenduar se punonjësi ***** e ka ofenduar, akuzuar dhe kërcënuar atë, me një fjalor që nuk e lejon etika dhe rregullat e administratës publike. Pra, në kundërshtim me përcaktimet e aktit nënligjor si më sipër, ankesa nuk i është paraqitur eprorit direkt, Drejtorit të Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, por Sekretarit të Përgjithshëm që është nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Veç kësaj, ankesa/raportimi, është paraqitur dorazi, duke mos e paraqitur në Zyrën e Arkiv Protokollit sipas procedurave normale administrative. Në përmbajtjen e shkresës me nr. 5801/1 prot., datë 2.8.2017, “*Kthim përgjigje*”, institucioni sqaron Komisionerin se, pozicioni i eprorit direkt që në këtë rast është Drejtori i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, është vend vakant. Në rrethanat konkrete, në cilësinë e eprorit direkt paraqitet pozicioni që vjen direkt pas tij, që bazuar në strukturën dhe organikën në fuqi është Drejtori i Përgjithshëm i Administrimit të Ujërave dhe Tokës. Në këto rrethana, ankesa për shkeljen disiplinore të pretenduar, duhet t’i përcillej nëpërmjet Zyrës së Arkiv Protokollit, Drejtorit të Përgjithshëm të Administrimit të Ujërave dhe Tokës dhe jo Sekretarit të Përgjithshëm.

Së dyti: Me urdhrin nr. 326, datë 19.7.2017 të Sekretarit të Përgjithshëm, është ngritur Komisioni Disiplinor i përbërë nga 5 anëtarë. (*Sekretari i Përgjithshëm, kryesues; Drejtori i Përgjithshëm i Administrimit të Ujërave dhe Tokës, si epror direkt, anëtar; Drejtori i Shërbimeve të Brendshme, si drejtues i njësisë së burimeve njerëzore, anëtar; një përfaqësues i Departamentit të Administratës Publike, anëtar dhe nëpunësi civil më i vjetër i institucionit, anëtar*). Por më pas, rezulton se dy anëtarë të KD janë zëvendësuar.

Konkretisht, me vendimin nr. 25, datë 24.7.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, anëtari i KD ***** është zëvendësuar me *****, Drejtor, në Inspektoratin Shtetëror të Ujërave dhe me vendimin nr. 26, datë 24.7.2017, të Sekretarit të Përgjithshëm, anëtari i KD ***** është zëvendësuar me *Irma Bregasi*, Specialist, në Sektorin e Sigurisë dhe Cilësisë së Produkteve Ushqimore, në Drejtorinë e Sigurisë Ushqimore.

Nga aktet që janë administruar gjatë hetimit administrativ, (*dokumentet bashkëlidhur shkresës nr. 5801/1 prot., datë 2.8.2017, “Kthim përgjigje”, të MBZHRAU*), vëmë re se, nëpunësi *G. Xhixha*, ka plotësuar deklaratën “*Deklaratë për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komisionit Disiplinor*”, e cila është pa datë dhe pa protokoll, ku deklaron se gjendet në rastet e parashikuara nga neni 37 i KPA (*rastet e konfliktit të interesave sipas KPA, të shfuqizuar*). Ndërsa për nëpunësin *I. Tarëlli*, nuk provohet që të ketë bërë vetë deklaram për pengesa ligjore për të qenë anëtar i KD, apo të ketë bërë kërkesë me shkrim për përjashtimin e pjesëmarrjes si anëtar i organit kolegjal (KD), në procedurën administrative.

Në këtë rast, përjashtimi i anëtarit ***** është bërë pa pasur një kërkesë apo njoftim nga ana e tij për përjashtim nga pjesëmarrja në vendimmarrje, e po kështu, përjashtimi i të dy anëtarëve të KD nuk ka marrë pëlqimin e KD, pasi nuk ka një vendim të këtij organi në lidhje me këtë aspekt që analizuar.

Referuar fakteve si më sipër, përjashtimi i anëtarëve të KD, ***** e ***** dhe zëvendësimi i tyre me nëpunës të tjerë, është bërë me nxitim, duke mos respektuar procedurat ligjore që rregullojnë garantimin e paanshmërisë së administratës publike në një rast të tillë, të parashikuara nga neni 30, 31 e 32 i ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”. Në mënyrë të shprehur pika 1, e nenit 32 të KPA, përcakton se: “*Eprori ose organi kolegjal, i njoftuar sipas nenit 31, të këtij Kodi, merr vendim për përjashtimin ose konfirmimin e nëpunësit, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit ose kërkesës së palëve*”.

Së treti: Në lidhje me veprimin konkret që është pretenduar se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij, konstatohet se, si shkak për marrjen e masës disiplinore objekt i këtij inspektimi, është parashtruar sjellja e parregullt e nëpunësit ***** gjatë orarit të punës, në ambientet e institucionit, gjatë një debati verbal me kolegen ***** me detyrën e përgjegjëses në sektorin ku ai punon si specialist, pasi ai ka përdorur fjalor shumë të rëndë, duke e fyer dhe kërcënuar atë.

Në këtë rast, konstatohet se nga ana e organit disiplinor është marrë i mirëqenë pretendimi i zj. *M. Shahini*, pasi për këtë fakt, nuk rezulton të jetë paraqitur apo administruar, ndonjë provë, dokument apo dëshmi nga persona që kanë qenë prezent në ngjarjen e pretenduar.

Nëpunësja ***** në përmbajtjen e ankesës për fillimin e ecures disiplinore, që mban datën 13.7.2017, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm, ka parashtruar që për të vërtetuar

pretendimet e saj, duhet të këqyren kamerat e institucionit. Po kështu, ajo ka përmendur si dëshmitarë nëpunësit *****, ***** dhe *****.

Konstatohet se, gjatë këtij procedimi disiplinor, nga ana e KD, në asnjë rast nuk janë kryer veprime që të provojnë pretendimet e palës që ka kërkuar fillimin e ecurisë, të tilla si pyetja e punonjësës që ka kërkuar fillimin e ecurisë, këqyrja e kamerës së institucionit apo turrja e dëshmitarëve, për të dhënë sqarimet apo mendimin e tyre për këtë rast. Po kështu, nga ana e KD, nuk është marrë parasysh asnjë kërkesë e punonjësit të proceduar dhe nuk është hetuar në lidhje me pretendimet e tij.

Komisioni disiplinor, me 4 vota pro dhe 1 votë kundër, (*përfaqësuesi i DAP ka votuar kundër*), ka konkluduar për marrjen e masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, e cila është ndëshkimi më i rëndë administrativ, për një nëpunës civil, bazuar vetëm në një kërkesë të paraqitur në datën 13.7.2017, para Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit, ashtu si e analizuam më sipër.

Në kushtet kur, ligji nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, në nenin 82, përcakton se: “*Në procedurat administrative të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e përmendura bie mbi këtë palë....*”, rezulton se, pala që ka pretenduar për shkeljen disiplinore, nuk e ka përmbushur këtë detyrim. Organi disiplinor, KD në këtë rast, nuk ka kryer asnjë veprim për hetimin e shkeljes së pretenduar dhe rrethanave të kryerjes së saj, duke mos respektuar në këtë mënyrë, përcaktimet e pikës 14, të VKM nr. 115, datë 5.3.2015, ku përcaktohet se organi disiplinor vlerëson të gjitha faket, të gjitha rrethanat që janë të nevojshme për marrjen e vendimit, si dhe mund të përdorë çdo mjet për të mbledhur prova, në përputhje me KPA. Në këtë dispozitë janë të përcaktuara edhe veprimet e domosdoshme që duhet të kryejë organi disiplinor ku një ndër to është, pyetja dhe marrja e deklaratave nga dëshmitarët. Pra, masa disiplinore është marrë pa bërë një hetim dhe vlerësim të fakteve dhe rrethanave të pretenduara si shkelje disiplinore.

Së fundi, konstatohet se, nga ana e organit të disiplinës, KD, nuk janë mbajtur parasysh parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masës disiplinore, të përcaktuara në nenin 60, të ligjit për nëpunësin civil. Në këtë përfundim, Komisioneri ka arritur në kushtet kur provohet se: **a)** KD nuk ka hetuar shkaqet dhe rrethanat e rastit, për të mundësuar më tej vlerësimin e nivelit të pasojave të ardhura, **b)** nuk ka marrë parasysh faktin që punonjësi nuk ka masa të tjera disiplinore, **c)** nuk është marrë parasysh fakti që dy vlerësimet e fundit të rezultateve individuale në punë, të cilat kryhen nga eprori direkt janë në nivelin 2 “*Mirë*” (vlerësimet për periudhën 1 korrik – 31 dhjetor 2016 dhe 1 janar -30 qershor 2017), **d)** nuk janë marrë parasysh përcaktimet e pikës 2, të dispozitës së sipërcituar, e cila parashikon se masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer, pasi, kategoria e shkeljes “*sjellje e parregullt, gjatë kohës së punës, me eprorët, kolegët, vartësit dhe me publikun*”, në varësi të rrethanave të kryerjes së saj, (që janë rënduese kur shkelja është e përsëritur) është e cilësuar në ligj si shkelje e lehtë, (neni 57, pika 4/c) ose si shkelje e rëndë (neni 57, pika 3/ç) dhe nuk është parashikuar si shkelje shumë e rëndë, që të justifikohet largimi nga shërbimi civil, ashtu si e ka siç e ka cilësuar pa të drejtë Komisioni Disiplinor.

Pra, masa disiplinore në këtë rast, është marrë për një shkelje që nuk është e parashikuar në geramat “a”, deri “d”, të pikës 2, të nenit 57, të ligjit për nëpunësin civil, ku përcaktohet

kategoria e shkeljeve “shumë të rënda”, të cilat përlligjin masën disiplinore largim nga shërbimi civil.

Për më tepër, konstatohet se nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, punonjësi subjekt i kësaj mase është njoftuar se procedohet për shkelje të rënda disiplinore, ndërkohë që Komisioni disiplinor nuk ka kryer ndonjë rikualifikim të shkeljes gjatë procesit, të cilën duhet t`ja njoftonte menjëherë punonjësit të proceduar, por e ka përfunduar procesin duke pretenduar për shkelje shumë të rënda, ç`ka përfaqëson një shkelje flagrante të procedurës, duke mos i dhënë të drejtë nëpunësit të mbrohet për shkeljen që i është ngarkuar.

Të gjitha sa analizuam më sipër, të krijojnë përshtypjen e një veprimi të nxituar nga ana e të gjithë aktorëve që kanë qenë pjesë e zhvillimit të kësaj ecurie disiplinore, të cilët nuk kanë zbatuar kërkesat ligjore të vendosura për të siguruar respektimin e procedurave ligjore dhe të drejtave të nëpunësit civil, për të pasur një proces të rregullt ligjor gjatë një hetimi administrativ, në zbatim të parimeve të ligjit për nëpunësin civil dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se të gjitha aktet administrative që materializojnë veprimet që janë kryer për marrjen e masës disiplinore në këtë rast, duke filluar me aktin e njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore, duke përfshirë edhe vendimin nr. 27, datë 25.7.2017, për marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për punonjësin *****, e më tej, akti i Drejtorit të Shërbimeve të Brendshme për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, janë akte absolutisht të pavlefshme, në vështrim të nenit 108, nëntitulli “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se:

“Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij; ...”.

Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se organi kompetent për të filluar një ecuri disiplinore është eprori direkt, ose Komisioni i Disiplinës dhe jo Sekretari i Përgjithshëm, i cili në këtë rast, ka vepruar në kapërcim të kompetencës ligjore, pasi ka ushtruar tagrin ligjor të Komisionit të Disiplinës, ndërkohë që ky i fundit, ende nuk ishte krijuar.

Në këto rrethana, për të rregulluar ligjshmërinë e administrimit të shërbimit civil, të gjitha subjektet që kanë nxjerrë akte administrative absolutisht të pavlefshme në këtë rast, duhet që menjëherë të konstatojnë pavlefshmërinë absolute të tyre dhe të rregullojnë pasojat që kanë ardhur prej zbatimit të tyre, duke pasur parasysh përcaktimet e nenit 110, dhe 111 të Kodit të Procedurave Administrative, ku parashikohet shprehimisht se:

Neni 110

“Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute”

“1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. *Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit*”.

Neni 111

“Konstatimi i detyrueshëm i aktit absolutisht të pavlefshëm”

“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi”.

Mos zbatimi i procedurave ligjore, në rastet kur pretendohen shkelje disiplinore, cenon garancitë ligjore të zbatimit të parimeve të administrimit të shërbimit civil, për të siguruar qëndrueshmërinë e administratës publike në tërësi dhe të nëpunësit civil në veçanti, si pjesë e saj, si dhe vazhdimësinë e shërbimit civil, të parashikuar në mënyrë të shprehur në nenin 5, kreu II, në titullin *“Administrimi i shërbimit civil”*, të ligjit për nëpunësin civil.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, në nenin 35, të Rregullores, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A

1. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm, me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr. 5470 prot., datë 14.7.2017, *“Mbi fillimin e procedimit disiplinor”* dhe të marrë masat që të anulohet çdo akt administrativ që ka dalë mbi bazën dhe në zbatim të tij.
2. Të kërkoj nga Komisioni i Disiplinës që me synim rregullimin e situatës së ligjshmërisë së administrimit të shërbimit civil, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 27, datë 25.7.2017, për marrjen e masës disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për punonjësin *****.
3. Të kërkojë nga Drejtori i Shërbimeve të Brendshme, të konstatojë menjëherë, si akt administrativ absolutisht të pavlefshëm, vendimin nr. 32, datë 27.7.2017, *“Për largimin nga shërbimi civil dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, për punonjësin *****”* dhe të rikthejë në detyrën e mëparshme punonjësin *****, duke i paguar pagën me të gjitha komponentët e saj, që nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies financiare, deri në ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohen për këtë vendim, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; Komisioni i Disiplinës pranë Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave; Drejtori i Shërbimeve të Brendshme; Departamenti i Administratës Publike, si dhe ankuesi *****.

5. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **5** ditë.
6. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
7. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA